

## MASTER PROFESIONAL NË “MARKETING”

### OBJEKTIVAT E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Programi i studimit Master Profesional në “Marketing” synon ta pajisë studentin me:

1. Formimi i ekspertëve dhe specialistëve të kualifikuar nëpërmjet përvetësimit të njohurive të thelluara teorike dhe veçanërisht praktike në fushën e inovacionit dhe të përdorimit të tij, për menaxhimin e marketingut, promocionit dhe shitjeve.
2. Përgatitja e specialistëve të aftë të studiojnë fenomenet mediatike dhe dinamikat e reja të komunikimit për të ndërmjetësuar aksionin e aktorëve shoqërorë, biznesit, e më gjerë me publikun dhe median, për prezantimin apo reklamimin e produktit në treg apo në hapësirën publike.
3. Formimi i ekspertëve me aftësi të thelluara teorike dhe praktike në fushën e menaxhimit, administrimit dhe vlerësimit të projekteve në nivel lokal kombëtar dhe ndërkombëtar si për biznesin ashtu dhe për ato të zhvillimit ekonomik e shoqëror.
4. Të përcjellë tek studentët aftësitë shumë të mira në fushën komunikimit, televizionit dhe multimedias të aftë të studiojnë, kuptojnë dhe analizojnë problemet marketingut nga këndvështrimi mediatike, komunikativ dhe ato të imazhit.

### REZULTATET E TË NXËNIT

- Të demonstrojë ekspertizë në aspektet teorike dhe veçanërisht në aftësitë praktike të zbatueshme në fushën e tregjeve, standardeve, marketingut, reklamimit dhe promovimit etj.
- Zbatimi i një metode të re marketingu që përfshin ndryshime të rëndësishme në dizajnin ose paketimin e produktit, vendosjen e produktit, promovimin dhe çmimin e produktit.
- Të njohë, interpretojë dhe përdorë njohuritë teorike, praktikën dhe përvojën bashkëkohore ndërkombëtare në kontekstin dhe mjedisin shqiptar, në fushën e marketingut, promovimit dhe reklamës, në sektorë të ndryshëm të biznesit dhe ekonomisë.
- Të jetë në gjendje për veprim bashkëpunues ndërmjet qeverisë, akademisë, biznesit, ndërmarrjeve të vogla, të mesme dhe të mëdha dhe palëve të interesuara për zhvillimin e turizmit të qëndrueshëm.
- Të demonstroj aftësi të dallueshme në drejtimin e kreativitetit dhe përmirësimet e produktit ose procesit.
- Të njohë dhe të përdorë njohuritë teorike dhe praktike për rritjen e konkurrencës, identifikimin dhe shfrytëzimin e mundësive të reja të tregut etj.
- Të përdor njohuritë e marra për përdorimin efikas të burimeve dhe krijimin e një kulture inovacioni brenda një kompanie



maiora premunt / gjëra të mëdha na presin



## MUNDËSITË E PUNËSIMIT

Mundësitë për punësim pas përfundimit të studimeve:

- Punonjës dhe drejtues të politikës së zhvillimit, kërkimit dhe inovacionit në fushën e marketingut, shitjeve, promocionit, etj
- Specialist ose drejtues komunikimi në administratën publike
- Gazetar në media të ndryshme: TV, gazetë, radio, online
- Drejtues i komunikimit dhe organizator eventesh në ndërmarrjet e mëdha private
- Punonjës dhe drejtues projektsh të fushave të ndryshme të biznesit
- Specialist ose drejtues i komunikimeve në administratën publike ose ndërmarrjet publike.

**MASTER PROFESIONAL "MARKETING" 60 ECTS**

| Nr. | Sem. | Emri i lëndës | ECTS |
|-----|------|---------------|------|
|-----|------|---------------|------|

**A - Lëndë Bazë/ 5-10%/6 ECTS**

|   |   |                   |   |
|---|---|-------------------|---|
| 1 | 1 | Kërkimi marketing | 6 |
|---|---|-------------------|---|

**B - Lëndë Karakterizuese 30%-40%/ 18 ECTS**

|   |   |                         |   |
|---|---|-------------------------|---|
| 1 | 1 | Marketing Strategjik    | 6 |
| 2 | 2 | Marketingu ndërkombëtar | 6 |
| 3 | 2 | Marketing Shërbimesh    | 6 |

**C - Lëndë ndërdisiplinore ose Integruese /20-30%/18 ECTS**

|   |   |  |   |
|---|---|--|---|
| 1 | 1 | Komunikimi marketing i integruar                             | 6 |
| 2 | 2 | Digital Marketing Analytics (Analizë e marketingut digjital) | 6 |
| 3 | 2 | Menaxhimi inovacionit  | 6 |
| 4 | 2 | Menaxhimi i markës në ekonominë digjitale                    | 6 |
| 5 | 1 | Marketingu dixhital dhe media sociale                        | 6 |
| 6 | 1 | Menaxhim dhe vlerësim projektsh                              | 6 |
| 7 | 2 | Strategji komunikimi për mediat e reja                       | 6 |

**D - Lëndë plotësuese 10%/ 6 ECTS**

|   |   |                                |   |
|---|---|--------------------------------|---|
| 1 | 1 | Praktike dhe Zhvillim Karriere | 6 |
|---|---|--------------------------------|---|

**E - Detyrime përmbyllëse 10-20%/12 ECTS**

|   |   |   |    |
|---|---|---|----|
| 1 | 2 | Punimi i diplomës/Provim i përgjithshëm formimi | 12 |
|---|---|---|----|